

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Trojan Tactical Solutions-Elite Marines Academy” shpk**

**Neni 1
Ortakët themelues**

1.1 Shoqëria krijohet nga unë ortaku themelues:

- Z. Zoran Obradovic, i biri i Oliver, lindur në HRV, Croatia, shtetas Kroat, më 16.06.1971, shtetas Kroat, banues në Tiranë, mbajtë i Letërnjoftimit ID me nr. personal H13615001A, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar;

**Neni 2
Emërtimi**

2.1 Shoqëria emërtohet “Trojan Tactical Solutions-Elite Marines Academy” shpk.

**Neni 3
Forma juridike**

3.1 Forma juridike do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.) sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”.

**Neni 4
Selia**

4.1 Selia e Shoqërisë “Trojan Tactical Solutions-Elite Marines Academy” shpk është: Rruga e Rinasit TBP Nd. Nr. 7, Vorë, Tiranë.

**Neni 5
Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë**

5.1. Shoqëria “Trojan Tactical Solutions-Elite Marines Academy” shpk ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.2. Veprimtaria e Shoqërisë “Trojan Tactical Solutions-Elite Marines Academy” shpk, do të ketë për objekt: “Shërbim në fushën e edukimit, trajnimite të ndryshme si: trajnime detare, trajnime përmes të siguruarit, konsulencë, turizëm e tregti. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjeter që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.”

5.3 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakësohet në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 6
Kohëzgjatja**

6.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë kohore të pacaktuar.

**Neni 7
Kapitali i Shoqërisë**

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë “Trojan Tactical Solutions-Elite Marines Academy” shpk përfaqësohet nga 1 (një) kuotë me vlerë 100,000 (një qind mijë) lekë dhe nuk është paguar.

7.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë:

- Z. Zoran Obradovic, zotëruesh i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 (një qind mijë) lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Neni 8

Transferimi i kuotave

8.1 Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit

Neni 9

Asambleja e Përgjithshme

9.1 Vendimet merren nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet që ligji apo Statuti ia rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, Administratori kërkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Pergjithshme.

9.2 Vendimet e Asamblesë së Pergjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen në një regjistër të posacëm të mbajtur pranë selisë së Shoqërisë "Trojan Tactical Solutions-Elite Marines Academy" shpk.

9.3 Janë në kompetencën ekskluzive të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve marrja e vendimeve për sa i përket:

- a) ndryshimit të Statutit;
- b) riorganizimi i shoqërisë, ndarja, bashkimi, likujdimi, shndërrimi i shoqërisë;
- c) zmadhimi, zgjedhimi i kapitalit, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar nga vetë shoqëria me qëllim anullimin e tyre;
- d) emërimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- e) emërimi dhe shkarkimi i ekspertëve kontabël të autorizuar;
- f) miratimi i bilancit;
- g) si dhe të gjitha kompetencat e tjera që ligji dhe/ose Statuti jepin shprehimisht Asamblesë

Neni 10

Organet drejtuese

10.1 Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqërisë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur më prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratorët

Neni 11

Administratori i Shoqërisë

11.1 Shoqeria administrohet nga Administratori, person fizik që mund te jetë ose jo ortak i Shoqërisë.

11.2 Administratori eshte të detyruar të drejtojë Shoqërinë në përputhje me ligjin "Për tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", Statutin, vendimet e Asamblesë së Pergjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

11.3 Administratori i Shoqërisë emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do të qëndrojë në detyrë për një kohë prej 5 (pese) vjetësh.

11.4 Administratori i parë i shoqërisë emerohet:

- Z. Zoran Obradovic, i biri i Oliver, lindur në HRV, Croatia, shtetas Kroat, më 16.06.1971, shtetas Kroat, banues në Tiranë, mbajtë i Letërnjoftimit ID me nr. personal H13615001A, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar;

11.5 Administratori ka të gjitha kompetencat që i njeh ligji dhe Statuti i Shoqërisë.

Neni 12

Ligji i zbatueshëm dhe mosmarrëveshjet

12.1 Për sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, reference i bëhet legjislacionit shqiptar në fuqi.

12.2. Për të gjitha mosmarrëveshjet brenda shoqërisë që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi komponent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

12.3. Ky dokument redaktohet në 3 (tre) kopje origjinale.

Neni 13

Regjistrimi i shoqërisë në QKB

13.1 Për regjistrimin e shoqërisë "Trojan Tactical Solutions-Elite Marines Academy" shpk pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, emërohet administrator i shoqërisë.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nënshkruar nga ortaku themelues

ORTAKU THEMELUES
Zoran Obradovic



Data: 14.08.2023